

PËRDORIMI I GJUHËS SHQIPE NË EDICIONET E LAJMEVE NË RADIO-TELEVIZIONIN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE NË ALSAT M

**Adelina XHAFERI & Esmije VESELI, Universiteti i Tetovës
adelina.xhaferi@unite.edu.mk & esmije.veseli@unite.edu.mk**

Abstrakt

Gjuha shqipe, që nga lashtësia e deri më sot, mbetet një gjuhë e veçantë dhe me vlera të veçanta kulturore e kombëtare. Struktura dhe përmbajtja e saj kanë qenë gjithmonë objekt studimi për gjuhëtarë vendas dhe të huaj. Me kalimin e kohës, veçanërisht në hapësirat publike dhe mediatike, është rritur nevoja për ruajtjen dhe përdorimin e saj të drejtë. Ky studim synon të analizojë përdorimin e shqipes në edicionet e lajmeve në dy televizione në Maqedoninë e Veriut: Radio-Televizioni i Maqedonisë (RTM) dhe Alsat M. Duke përdorur metoda deduktive dhe krahasuese, shqyrtohet cilësia gjuhësore në shkrimin e lajmeve, titujve dhe përdorimi i fjalëve të huaja. Edhe pse njëri televizion është publik dhe tjetri privat, të dy përballen me sfidën e ruajtjes së standardit të shqipes në raportimin informativ. Rezultatet tregojnë se ndonëse ka përpjekje për përdorim korrekt, shpesh vërehen devijime nga norma standarde dhe ndikime të huaja të panevojshme. Studimi thekson nevojën për përmirësim të vazhdueshëm gjuhësor dhe vetëdijësim profesional në median shqipfolëse.

Fjalë çelës: Gjuha shqipe, përdorimi, lajmet televizive, e sotmja, shkrimi

Use of the Albanian Language in News Editions on The Radio-Television of North Macedonia and Alsat M

Abstract

The Albanian language, from its earliest history to the present day, remains unique with strong cultural and national significance. Its structure and richness have long attracted the attention of both Albanian and foreign linguists. In modern times, especially in public and media communication, the proper use and preservation of the language has become increasingly important. This study analyzes the use of Albanian in news editions broadcast by two television stations in North Macedonia: Radio-Television Macedonia (RTM) and Alsat M. Using deductive and comparative methods, the study evaluates linguistic accuracy in news writing, headlines, and the presence of unnecessary foreign terms. Although one station is public and the other private, both face the challenge of maintaining standard Albanian in informative content. The findings reveal efforts toward correct usage but also show frequent deviations from the literary norm and the influence of non-Albanian vocabulary. The study highlights the ongoing need for linguistic improvement and greater language awareness in Albanian-language journalism.

Keywords: Albanian language, usage, TV news, until today, reports

Hyrje

Në historinë e njerëzimit përpos të veçantave që dalin për zhvillimin e popujve dhe ngritjen e tyre nga shkalla në shkallë drejt një civilizimi dhe pasqyrimi të arrirë të vetvetes, të veçanta dalin edhe mënyrat se si popuj të ndryshëm në rrjedhë të kohës arritën të identifikoheshin me gjuhë të caktuara. Identifikimi i tyre nëpërmjet gjuhës nuk ishte vetëm një nevojë e kohës për t'u bërë pjesë e shoqërive njerëzore, të cilat dalloheshin për komunikimin me njëra-tjetrën, por edhe një nevojë e vazhdueshme për ta kuptuar rrjedhën e ndërtimit dhe ekzistimin e tyre. Me një identifikim të veçantë dhe zhvillim të natyrshëm prapa nuk mund të mbetej as gjuha e popullit shqiptar dhe mënyra se si ajo e realizoi vetveten, pavarësisht vendqëndrimit dhe zhvillimit. Andaj, e një rëndësie të madhe në ditët e sotme është të përdorurit e drejt të saj.

Gjuha shqipe është njëra ndër gjuhët me natyrë të veçantë në grupin e gjuhëve të ndryshme të botës, historia e të cilave është thënë me kohë se është vetë "historia e popujve që i flasin a i kanë folur" (Çabej, 1970, f. 9). Duke qenë e tillë, me tipare të caktuara gjuhësore, me karakteristika të ndryshme nga gjuhët tjera dhe duke u zhvilluar nga koha në kohë kjo gjuhë arriti që ta krijonte natyrën e vetvetes dhe me të gjitha tiparet e saj të bëhej pjesë e familjes së gjuhëve indoevropiane. Praninë e saj në familjen e tillë e pohojnë shumë studiues në vepra të ndryshme studimore, siç është edhe rasti i Cimohovski-t: "Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e madhe të gjuhëve indoevropiane dhe në kuadër të saj përbën grup të posaçëm, më vete, të barabartë me grupet e tjera, si grupet indo-iraniene, greke, italice, baltike, sllave etj." (Cimohovski, 1988, f. 16).

Për rrugëtimin e gjuhës dhe përshkrimin e natyrës së saj në rrjedhë të kohës u angazhuan njerëz të shumtë, si: gjuhëtarë, studiues, shkrimtarë e profesorë, krijimet dhe studimet e të cilëve duke u lidhur me gjenezën e popullit dhe me shenjën e parë të identifikimit (gjuhën) arritën të dëshmonin se pavarësisht ndryshimeve a shkatërrimeve të cilat do të binin mbi popull, do të ishte gjuha ajo që do ta ruante historinë e tyre. I mendimit të njëjtë në mesin e tyre doli edhe De Rada, zëri i letërsisë në botën arbëreshe, i cili tha se: "Fillimi e themeli i çdo diturie është gjuha, që popujve u mban gjallë kombësinë e tyre të shtrenjtë. Shtetet shkatërrohen e zhduken, trojet e disa fiseve zihen nga fiset tjera, por e vetmja cilësi që e shquan një popull dhe e bën të njihet kudo ku mund ta hedh fati, është vetëm gjuha- shprehet De Rada i madh" (Murati, 2000, f. 15).

Të informuarit e drejt të shoqërisë për ngjarje të caktuara të ndodhura brenda dhe jashtë vendit ka qenë nevojë e përhershme e shoqërisë njerëzore, ndërtimi dhe realizimi i së cilës u ndihmua po nga lajmet me të cilat lidhej përditshmëria e saj në hapësira të caktuara. Andaj, duke u ditur tashmë fakti se secila shoqëri njerëzore në rrjedhë të kohës ka qenë pjesë e ndodhive të ndryshme apo realizuese e tyre, në vetvete e ka pasur qëllimin e përhapjes së lajmit që lidhej me ndodhinë e saj dhe informimin e të tjerëve në lidhje me ecurinë dhe realizimin e një ndodhie. Në këtë mënyrë, nevoja e tillë, duke qenë se e karakterizonte përditshmërinë e çdo hapësire të afërt apo të largët, kaloi dukshëm nga njëra kohë në tjetrën duke u shoqëruar më pas edhe me elemente të natyrave të tjera, të cilat në mënyra të ndryshme e ndihmonin të parën dhe bënë që ajo të kishte natyrë të plotë. Duke e synuar të plotën e përmendur së fundmi, e plota në ditët e sotme kërkohet edhe në natyrën e gjuhës shqipe gjatë dhënies së edicioneve të ndryshme të lajmeve në televizionet shtetërore dhe televizionet private, të cilat duke qenë se e informojnë tjetrin (masën popullore) mbi ngjarje të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, duhet të kujdesen për një përdorim të drejtë.

Të informuarit e drejt të shoqërisë njerëzore për ngjarje e ndodhi të natyrave të ndryshme brenda hapësirës së vendit apo më larg saj, qofshin ato ngjarjet më të reja/të ndodhura së fundmi, apo edhe ato të kohëve të mëparshme, ka qenë nevojë e përhershme, e detyrueshme dhe e vazhdueshme që nga kohët e lashtë, kur masa popullore informohej mbi një lajm nëpërmjet njerëzve të caktuar, të cilët dilnin dhe gjatë të bërëtiturit në rrugë e lajmëronin tjetrin për çdo ndodhi a ndryshim, deri në ditët e sotme, ditë në të cilat shihet se informatat e përditshmërisë janë më të shpejta në kohë, më të plota në kuptimësi, apo edhe më të shumta në numër për dallim nga koha e kaluar. Gjithë këtë shpejtësi, plotësi apo mori të madhe të lajmeve deri në ditët e sotme shihet se e ndihmoi vetë zhvillimi i shoqërisë njerëzore. Ky zhvillim duke e kapërcyer kohën nga shkalla në shkallë dhe duke i shfaqur para të tjerëve nevojat e veta bëri që në të përditshmen e shoqërisë të krijoheshin mjete të duhura dhe burime më të plota informimi. Mjetet dhe burimet e tilla, duke e parë zhvillimin e njeriut dhe rrjedhën e menjëhershme të kohës për kapjen e gjërave të reja do të arrinin më lehtë të njerëzit dhe do të bënin që ata në kohë më të shpejtë dhe në mënyrë më të lehtë ta pranonin lajmin, apo porosinë që duhej të ishte në duart e tyre. Në këtë mënyrë, pavarësisht kohës, njerëzit do ta merrnin lajmin (qoftë atë të shkruar, apo të dhënë vetëm për dëgjim) ashtu siç kishte ndodhur dhe ashtu siç u jepej nga mjetet e ndryshme të informimit (me apo pa një përdorim të drejtë në vetvete).

Përdorimi i Gjuhës Shqipe në edicionet e lajmeve në Radio-Televizionin e Maqedonisë

Që natyra e gjuhës shqipe të dalë e plotë dhe ta ruajë në vetvete punën për të cilën në të kaluarën u munduan njerëz të caktuar, nuk duhet të ketë përdorim të drejtë (një normë standarde) vetëm tek institucionet edukative-arsimore, te tekstet e hartuara shkollore, apo te krijimet letrare të shkrimtarëve të ndryshëm, por edhe tek edicionet e lajmeve të dhëna në televizione të ndryshme. Vetëm në këtë rast, qoftë në interes të punimit në fjalë, qoftë në interes të rendit të përditshëm në medie (informues), duke u angazhuar në mënyrë të përbashkët dhe me një punë të pandërprerë e të nevojshme për t'u bërë model i kohëve më të reja/ të vonshme, gjuha shqipe do ta japë natyrën e plotë pa u ndikuar nga gjuhët e huaja dhe nga prishja e rendit mbi të cilin ndërtohet. Në këtë mënyrë, në brendi të këtij punimi nuk duhet harruar pa u përmendur fakti i pohuar me kohë, se: "Gjuha standarde shqipe, shqipja standarde ose gjuha letrare kombëtare pa dyshim se është një arritje jashtëzakonisht e madhe e kombit shqiptar. Kjo arritje me rëndësi kolosale është rezultat e fryt i përpjekjeve historike të atdhetarëve, shkrimtarëve, gjuhëtarëve, arsimdashësve e arsimdashëseve, gazetarëve, politikanëve etj., përpjekjet e të cilëve nisën shumë më herët se 1944-a dhe jo thjesht rezultat, arritje a fryt i një akti të vetëm administrativ, siç është Kongresi i Drejtshkrimit (1972, Tiranë). Shqipja standarde ose gjuha letrare kombëtare është gjithashtu pasuri e mbarë kombit tonë, pavarësisht nga kufijtë shtetërorë e rendet politike". (Sulejmani B. , 2011, f. 17)

Në të gjitha rastet në të cilat shihet nevoja e përdorimit të drejt të saj, njerëzit duhet ta bëjnë të pamundurën për ruajtjen e gjuhës, sepse nëse shoqëria njerëzore do të vazhdonte të komunikonte vetëm me shenja të bartura nga ditët e para të krijimit, boshllëku i saj do të ishte shumë i madh dhe mënyra e funksionimit të asaj shoqërie nuk do të ishte e drejt. Këtë gjë e kanë shprehur me kohë studiues të natyrave të ndryshme, të cilët nevojën e respektimit dhe përdorimit të saj e panë të njëjtë me nevojën e respektimit të ligjeve të shtetit. Ja se si del ky pohim me fjalët e mëposhtme: "Drejtshtkrimi ose norma letrare gjuhësore e shqipes është njësoj sikurse kushtetuta e shtetit me ligjet e saj. Ashtu sikurse nuk mund të funksionojë shteti nëse shkelen ligjet kushtetuese, po ashtu nuk mund të funksionojë as gjuha shqipe si duhet nëse nuk përfillen rregullat e saj drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore". (Murati, 2000, f. 61)

"Gjuha s'ka dyshim, është një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut. Në mesin e mijëra llojeve të shtazëve, vetëm njeriu është zotërues i gjuhës". (Frashëri, 2002, f. 16) Duke u mbështetur në këtë pohim të përmendur kohë më parë, shihet se në mesin e gjuhëve të cilat e karakterizojnë historinë e botës dhe çdo shoqëri të caktuar brenda saj, edhe gjuha shqipe, me natyrën dhe zhvillimin e saj nga shkalla (periudha) në shkallë (periudhë) është veçoria më e rëndësishme e njeriut. Duke qenë se gjuha shqipe është një gjuhë me shtrirje të gjerë dhe me folës të saj në vende të ndryshme, me të gjitha elementet gjuhësore dhe dukuritë e saj karakterizuese, të cilat i ka bartur nga vetvetja ose i ka ruajtur si të përbashkëta me gjuhët tjera me të cilat ka qenë në kontakt të vazhdueshëm, përpos rasteve të tjera, përdorim të theksuar në ditët e sotme gjen edhe në edicionet e lajmeve në *Radio-Televizionin e Maqedonisë*. Duke e ditur faktin se në këtë televizion shtetëror kjo gjuhë duhet të ketë një natyrë të pastër, të mbështetet në drejtshkrimin e saj, në drejtshqiptimin e fjalëve të saj, si dhe të ndiqet nga rregullat me të cilat duhet të dalë e shkruar në mediat informuese (e jo vetëm), në rastin e këtij punimi, siç edhe do të shihet më poshtë, do të kuptohet se jo gjithmonë përdorimi i saj i përditshëm brendapërbrenda këtij televizioni është në nivelin e duhur.

Duke qenë se me kohë është theksuar fakti se: "*Të folurit nuk është gjë e përbërë vetëm nga shqiptimi i atyre zërave, e madje, as nga shqiptimi i atyre fjalëve të plota e të përsosura. Të folurit do të thotë, të shprehësh qëllimin dhe të kuptosh qëllimin, që shprehet me fjalë dhe fjali, të formuara me zëra të artikuluar a fonema*" (Frashëri, 2002, f. 39) televizionet e sotme shtetërore (dhe jo vetëm) duhet të bëjnë kujdes të madh në mënyrën e dhënies së një lajmi/informacioni te masa popullore, e cila duke qenë se është e prirë që gjithmonë ta ndjekë atë shembull që i jepet nga tjetri nëpërmjet një mjeti të caktuar, do të niset gjithmonë që ta përdorë në mënyrë të gabuar një fjalë të sotme të gjuhës shqipe. Duke u ndalë në këtë mendim dhe duke u ditur në vetvete nevoja e madhe për një shqipe të pastër e të drejt dhe të mbajtur larg nga ndikimet e huaja nga të gjithë faktorët bartës të saj kërkohet që ajo të mbrohet dhe të jepet në mënyrë të drejt. Andaj, është në interes të këtij punimi dhe në nevojë të vetë medias që të paraqitet në mënyrë konkrete përdorimi i gjuhës shqipe në edicionet e lajmeve në *Radio-Televizionin e Maqedonisë*. Lajmet të cilat do të jepen më poshtë janë vetëm tekste të edicioneve të lajmeve të këtij televizioni dhe si të tilla do ta dëshmojnë në mënyrë konkrete (mos)përdorimin e gjuhës shqipe në këtë televizion të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut:

Në lajmin e dhënë në *Radio-Televizionin e Maqedonisë* më 3 tetor 2024 me titull "*Shëndeti mendor tek të rinjtë, shkollat të përgatiten më profesionalisht për kujdes*" (Qamili, 2024) shihet se pjesa e dytë e titullit bartës të lajmit është përdorur në formë jo të drejt dhe se te teleshikuesit (pavarësisht se në cilin edicion jepet apo se në cilën ditë lexohet në faqet e internetit të këtij televizioni) nuk e përcjell porosinë e nevojshme. Kjo gjë thuhet duke u mbështetur në nevojën e vazhdueshme që teleshikuesit të informohen drejt mbi ngjarje dhe ndodhi të caktuara brenda dhe jashtë vendit të tyre, si dhe ta marrin drejt atë porosi për të cilën kanë nevojë si individë apo si shoqëri. Forma më e drejtë e titullit të lajmit në fjalë do të ishte: "*Për shëndetin mendor te të rinjtë shkollat duhet të kenë personel të duhur*". Në këtë mënyrë te teleshikuesit do të përcillej lehtë dhe qartë nevoja e madhe që secila shkollë në vend, si institucion edukativ-arsimor të ketë njerëz të duhur (shërbime pedagogjike), të cilët brenda hapësirës së saj do të kujdesen për shëndetin mendor të të rinjve, ndihmë dhe kujdes të cilin siç dihet nuk mund ta japin të punësuarit tjerë në shkollë, të cilët nuk janë të fushës së nevojshme. Në këtë mënyrë dihet se shërbimi i duhur, me metoda të përdorura dhe të nevojshme për përdorim do të ndikonte në shëndetin e të rinjve, jo vetëm brenda shkollës, por edhe në hapësira tjera jashtë objektit të shkollës. Gjithashtu, duhet përmendur dhe fakti se në brendinë e tekstit të këtij lajmi, autorët (gazetarët) pos titullit jo të drejt

kanë përdorur edhe fjalë të huaja, si fjalët: *tangon, fokus, kostoja, involvuara dhe intervenuam*, të cilat duhej të paraqiteshin me fjalët e gjuhës shqipe, si: *shqetëson, vëmendje, çmim, përfshirje dhe ndërhyrje*. Në këtë mënyrë do të lihej anash fjala e gjuhës së huaj bashkë me "ndikimin" që ajo ka në gjuhën shqipe, si dhe shqipja te teleshikuesit (lexuesit) do të dilte e pastër.

Në një titull tjetër lajmi të dhënë më 8 tetor 2024, brenda këtij televizionit thuhet: "*SHBA, 17.9 miliardë dollarë ndihma ushtarake Izraelit që nga 7 tetori i vitit 2023*". (Amerikës, 2024) Siç shihet nëpërmjet këtij titulli teleshikuesit gjatë dhënies së lajmit duhet të kuptojnë dhe të mësojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës që nga 7 tetori i vitit të kaluar kanë ndarë ndihma ushtarake për shtetin e Izraelit në vlerë prej 17.9 miliardë dollarë. Që teleshikuesit ta kuptonin menjëherë këtë gjë dhe të mos mendoheshin shumë në të kuptuarit e lajmit, titulli më i drejtë do të ishte: "*SHBA ka dhënë 17.9 miliardë ndihma ushtarake për Izraelin që nga viti i kaluar*". Në këtë mënyrë duke e përdorur parafjalën "për" (parafjalën e rasës kallëzore) të shkruarit e titullit të lajmit do të ishte më i drejtë dhe më lehtë i kuptueshëm për të tjerët.

Një titull mjaft interesant për nga mënyra e shkrimit dhe përfshirjes së pjesëve të padrejta për strukturën e tij, në edicionin e lajmeve të televizionit në fjalë është edhe: "*Politikania që i pëlqen të provokojë dhe të jeton ndryshe, kush është kandidatja e AfD për kancelare në Gjermani?*" (DW, 2024), titull ky në të cilin shihet se pjesa e parë nuk e paraqet drejt të shkruarit e gjuhës shqipe dhe se brenda vetes ka fjalë të cilat nuk e kanë vendin e duhur, siç është rasti me foljen "*provokim*". Ndonëse të shkruarit e titujve të lajmeve në raste të caktuara bëhet si nevojë e tërheqjes së shikueshmërisë (lexuesve), fjala e tillë në asnjërin rast nuk duhet që të përfshihet në lajmet e televizioneve shqiptare. Do të thotë kjo pjesë e lajmit mund të mos ishte përfshirë aspak dhe, edhe pa të, teleshikuesit apo lexuesit do ta kishin në vetvete interesin e duhur për ta njohur kandidaten për kancelare në Gjermani sipas asaj që kanë shkruar autorët (gazetarët). Kështu ata nuk do të niseshin nga fakti i panjohur se për ç'provokim të kandidatës është fjala, meqë do të duhej ta njihnin vetëm për përpjekjen, garën e saj për ta zënë një vend të tillë të rëndësishëm në shtetin e Gjermanisë. Do të thotë, duke u nisur nga nevoja e vazhdueshme që gjuha shqipe të tingëllojë dhe të dalë e pastër si në të shkruar, ashtu edhe në të folur (Sinani, 2016), titulli i lajmit të këtillë me gjithë tekstin e tij do të ishte më mirë ta kishte këtë formë: "*Kush është kandidatja e AfD-së për kancelare në Gjermani?*"

Një titull tjetër në televizionin në fjalë që nuk e ka të përdorur drejt të shkruarit e gjuhës shqipe është edhe titulli i lajmit të publikuar më 9 tetor 2024, si me fjalët e mëposhtme: "*Foshnja 14-muajshë që ndërroi jetë është endur 5 ditë nga spitali në spital*". (RTM, 2024) Në këtë titull lajmi shihet se folja "*jam*", pra folja ndihmëse e gjuhës shqipe që në këtë rast ka të bëjë me vetën e tretë të numrit njëjës është përdorur në kohën e tashme, ndërsa gjithçka tjetër e lajmit shihet se ka të bëjë me ndodhinë e të kaluarës dhe me fatin e foshnjës 14-muajsh. Siç shihet më pas në brendi të tekstit, foshnja në fjalë për pesë ditë me radhë ishte endur nga spitali në spital dhe në fund e kishte humbur jetën. Pra, forma e drejtë në shkrimin e titullit të këtij lajmi do të ishte: "*Foshnja 14-muajshë që ndërroi jetë ishte endur pesë ditë nga spitali në spital*", që do të thotë se folja e lartpërmendur "*është*" në brendi të lajmit duhej të shkruhej në kohën e kaluar "*ishte*" dhe ashtu siç e kërkon drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i gjuhës shqipe gjithë lajmi të ishte në përputhje me kohën në të cilën kishte ndodhur ngjarja.

Titulli i lajmit të radhës që brenda vetes ka një renditje dhe përdorim të gabuar të gjuhës shqipe është ai i dhënë në *Radio-Televizionin e Maqedonisë* më 5 tetor 2024, si me fjalët e mëposhtme: "*Gjithnjë e më pak lindje në vend, numri i foshnjave pëson rënie drastike*". (RTM, 2024) Në të lexuarit e parë të këtij titulli (pa e analizuar mirë se cili është qëllimi i të shkruarit të lajmit brenda televizionit

të përmendur) kuptohet se rënie të madhe pëson numri i foshnjave, do të thotë çdo mendim niset te numri dhe jo te foshnjat e lindura të cilat në vend çdo vit e më shumë janë më të pakta. Andaj, duke e ditur nevojën e të shkruarit drejt të shqipes dhe dhënien e porosisë në formë të saktë, vëmendja e teleshikuesve/lexuesve të këtij lajmi duhet të jetë te foshnjat e pakta të lindura brenda vitit, pra te lindjet e reja të cilat në vend paraqesin ulje të madhe. Nga kjo, forma e drejt e titullit të lajmit brenda televizionit në fjalë do të ishte: *"Gjithnjë e më pak foshnje të lindura në vend, ulet numri i lindjeve të reja"*.

Përdorim të një fjale jo të drejt dhe të gabuar në mesin e fjalëve të lajmit shihet edhe në titullin e lajmit të dhënë më 30 shtator 2024: *'Gruevskit i skadoi dënimi me burg, vjetërsohet lënda e rastit "Tanku"'*. (RTM, 2024) Siç shihet në vend të fjalës së huaj, pra foljes *"skadoi"* në këtë lajm duhej të ishte përdorur fjala shqipe, pra folja *"kaloj"*, ndërsa forma e drejt e titullit të lajmit do të ishte: *'Gruevskit i kaloi koha e dënimit me burg për lëndën e rastit "Tanku"'*. Me këtë rast do të kuptohej se lënda e rastit në fjalë për shkak të vjetërsimit nuk mund të bëhet shkak për dënimin e personit të përmendur dhe se, edhe në këtë titull të lajmit të televizionit në fjalë duhej të mbaheshin larg fjalët të cilat nuk e kanë vendin në atë mes.

Pra, siç shihet vetëm nga shembujt e dhënë në këtë punim dhe nga mënyra e të shkruarit të teksteve të lajmeve në fjalë, përdorimi i gjuhës shqipe dhe respektimi i normave të saj në këtë televizion nuk është në nivelin e duhur. Siç u pa edhe më lart, gabime më të theksuara të paraqitjes së gjuhës shqipe nuk ka vetëm në të shkruarit e titujve të lajmeve (të cilët siç u përmend, në të shumtën e rasteve përdorin fjalë jo të drejta për shikueshmëri/leximi), apo në brendinë e teksteve, por edhe në përdorimin e panevojshëm të fjalëve të huaja, të cilat në kohët e fundit, në ditët e sotme po zënë vend gjithnjë e më të panevojshëm, gjë e cila paraqet shqetësim serioz. Që kjo gjë të përmirësohet dhe përdorimi i gjuhës shqipe në këtë televizion të dalë ashtu siç duhet dhe siç kërkohet nga vetë rregullat e kësaj gjuhe, televizioni duhet të angazhojë lektorë e redaktorë të gjuhës, të cilët do të kujdesen për titujt, për brenditë dhe për paraqitjet e lajmeve te masa popullore.

Përdorimi i Gjuhës Shqipe në edicionet e lajmeve në *Alsat M*

Përdorimin e saj të veçantë gjatë të shkruarit të lajmeve të ndryshme gjuha shqipe e gjen edhe në televizionin privat *Alsat M*, televizion ky i vendosur brenda hapësirave të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ashtu si në pjesën e dhënë më sipër brenda këtij punimi, te e cila u pa se si dilte gjuha shqipe në natyrën e lajmeve të fushave të caktuara, edhe në këtë pjesë do të shihet përdorimi i saj i drejt apo i gabuar në disa tekste të caktuara të marra nga edicionet e lajmeve të ndryshme. Që në fillim të kësaj pjese, për këtë punim, vlen të theksohet fakti i përmendur me kohë se: *"Kërkesa themelore e shprehjes gjuhësore është që ajo të jetë e qartë, e thjeshtë dhe e kuptueshme për të gjithë"*. (Murati, 2000, f. 78)

Duke u mbështetur në këtë kërkesë dhe në nevojën e vazhdueshme që gjuha shqipe të dalë sa më lehtë e kuptueshme te bota e teleshikuesve, dëgjuesve apo lexuesve të lajmeve të ndryshme, mjetet informuese duhet ta kenë në vetvete rregullin e përdorimit të drejt të saj. Vetëm në këtë mënyrë ajo do të mbrohet nga përfshirja e fjalëve me prejardhje të huaj, do të kujdeset për një rend të drejt të fjalëve në fjali, do të niset për një përdorim me fjalë burimore shqipe, si dhe do ta ketë nevojë të përhershme paraqitjen e saj sipas normave të (para)caktuara gjuhësore. Për ta parë përdorimin e kësaj gjuhe në televizionin e lartpërmendur dhe mënyrën e shkrimit të lajmeve (me tituj dhe brendi lajmi) të saj nga gazetarët (autorët) e këtij televizioni po jepen në mënyrë konkrete shembujt e lajmeve të mëposhtme:

Në lajmin e publikuar më 9 tetor 2024 në *Alsat M*, në televizionin privat brenda hapësirave të Republikës së Maqedonisë së Veriut me titull: *"Sulmet izraelite vrasin të paktën 12 palestinezë në Gazë"*

(Lirë, 2024) shihet se vëmendja e teleshikuesve dhe lexuesve të lajmit duhet të jetë te të paktën dymbëdhjetë palestinezët e vrarë nga sulmet e izraelitëve. Andaj duke e ditur këtë nevojë për informim të drejt dhe nevojë të të shkruarit drejt të gjuhës shqipe gjatë transmetimit të edicioneve të lajmeve, titulli i lajmit duhej të ishte titulluar në këtë mënyrë: “Nga sulmet izraelite, në Gazë mbetën të vrarë 12 palestinezë”. Në këtë mënyrë për teleshikuesit dhe lexuesit e lajmit në televizionin në fjalë do të dihej shumë më lehtë se nga cili faktor i jashtëm u kishte ardhur vdekja dymbëdhjetë palestinezëve të lartpërmendur dhe se në cilën anë kishte qëndruar faktori i jashtëm që e kishte shkaktuar të keqen e tyre. Pra, nga ky titull lajmi vëmendja e plotë do të binte mbi faktorin dëmbërës, me ç’rast do të njihej fati i dymbëdhjetë palestinezëve në Gazë.

Në lajmin tjetër të publikuar më 7 tetor 2024 me titull “Si SHBA mundi Kinën në garën për dominimin e AI: Cili është sekreti i suksesit të ChatGPT” (Alsat, Alsat, 2024) që në emërtim përpos mungesës së dukshme të pikëpyetjes, si shenjë pikësimi, e cila duhej të qëndronte në fund të fjalisë së përdorur dhe përpos rendit jo të drejt të fjalëve në fjali, shihet edhe përdorimi i fjalës së huaj “dominim”, në vend të së cilës duhej të përdorej fjala e gjuhës shqipe “mbizotërim”. Duke e respektuar këtë gjë dhe normën e gjuhës shqipe, titulli i lajmit do të ishte: “Si e mundi SHBA Kinën për mbizotërimin e AI: Cili është sekreti i suksesit të ChatGPT-së?”. Përpos pikave të sapo përmendura, në këtë tekst të paraqitur siç shihet ka edhe fjalë të cilat nuk janë përdorur me natyrë të drejt dhe të nevojshme për këtë pjesë. Si të tilla ato jo vetëm që tregojnë për një pakujdesi të vazhdueshme ndaj përdorimit të gjuhës shqipe, por edhe për një nxitje të panevojshme dhe të gabuar të të tjerëve për ta përdorur dhe përfshirë në fjalorin e përditshmërisë së tyre fjalën me burim të huaj. Në lajmin në fjalë, përdorim të fjalëve të huaja paraqesin fjalët e mëposhtme: spikatur, drastike, total, aksesin, bazuar, lider, inovacionit, inkurajojnë, efektshme dhe izolon. Në vend të tyre, që lajmi i dhënë të tingëllonte shqip, të tingëllonte më bukur dhe të respektoheshin aq sa duhet normat dhe rregullat e shkrimit të gjuhës shqipe, duhej të përdreshin fjalët shqipe, si: dallim, të madhe, gjithsej, qasje, mbështetur, udhëheqës, risi, nxisin, ndikuese dhe mbyll.

Në lajmin e radhës të dhënë më 8 tetor 2024 me titull “Ulja e marzhës nuk vërehet në terren, qytetarët: Çmimet e produkteve janë të larta” (Alsat, Alsat, 2024) shihet se teleshikuesit dhe lexuesit e lajmit duhet të informohen për çmimet e larta të cilat i kanë produktet e ndryshme ushqimore brenda territorit të vendit dhe se si këtë çmim të lartë të paraqitur në treg më së shumti e vuajnë qytetarët e vendit. Pra, vëmendja e lajmit të dhënë gjatë edicioneve të lajmeve duhet të jetë te pohimi i qytetarëve se si pavarësisht uljes së përqindjes së çmimit, produktet ushqimore sërish mbajnë çmime të larta. Në këtë mënyrë, që titulli të ishte në përputhje me përdorimin e drejt të gjuhës shqipe dhe që në vetvete të kishte vetëm fjalë të kësaj gjuhe, pa u ndikuar nga fjalët e huaja, të cilat nuk duhet që të jenë të përfshira as gjatë transmetimit të lajmeve duhej të tingëllonte në këtë mënyrë: “Ulja e çmimeve nuk vërehet në treg, qytetarët thonë se produktet janë ende me çmime të larta”. Pra, në vend të fjalës “terren” në shkrimin e lajmit në fjalë duhej të ishte përdorur fjala “treg”, ndërsa në vend të fjalës “marzhë” teleshikuesit dhe lexuesit t’i jepej fjala “përqindje e çmimit”.

Lajmi me titull “Rrahen mes vete dy kirurg në Spitalin e Tetovës - Jo zyrtarisht janë përdorur edhe mjete të forta!” (Sulejmani B. , 2024) të publikuar më 9 tetor 2024 në televizionin në fjalë që në fillim të tij, pra që në fjalët e para të dhëna në titull vërehen gabime të njëpasnjëshme të përdorimit dhe shkrimit të gjuhës shqipe. Në vend të foljes “rrahe” e cila nuk është shkruar në formë të drejt duhet të shkruhet folja “janë rrahur”, meqë veprimi i dy kirurgëve në fjalë i takon të kaluarës dhe si veprim i kryer duhet të paraqitet edhe te teleshikuesit a lexuesit e lajmit. Përpos saj shihet se te fjala “kirurg” mungon ë-ja fundore, e cila në këtë rast duhet të vihet meqë flitet për numrin shumë. Brenda titullit në

fjalë shihet se edhe pjesa e dytë e lajmit duhet të dilte në një formë tjetër dhe në këtë mënyrë fjala “jo zyrtarisht” e përdorur në të, të çonte te lajmi i cili është marrë në mënyrë jozyrtare dhe jo te përdorimi i mjeteve të forta, të cilat sipas natyrës së titullit duhet të jenë përdorur jo zyrtarisht. Duke u ditur kjo gjë, duke qenë e nevojshme që gjuha shqipe të ketë një pasqyrim të rregullt edhe në edicionet e lajmeve të ndryshme brenda territorit të Maqedonisë së Veriut, titulli i lajmit në fjalë duhej të ishte, si më poshtë: “Gjatë rrahjes së dy kirurgëve në Spitalin e Tetovës, jo zyrtarisht thuhet se mund të jenë përdorur edhe mjete të forta”.

Në lajmin e publikuar më 9 tetor 2024 me titull: “E rëndë në Itali, shqiptari mbyt bashkëshorten në sy të fëmijëve” (CNN, 2024) shihet se në pjesën e parë të lajmit për teleshikuesit dhe lexuesit e televizionit të lartpërmendur mbetet e papërcaktuar se çfarë është ajo gjë e rëndë që paska ndodhur në Itali. Vetëm gjatë të lexuarit të lajmit kuptohet se te familjet shqiptare të cilat jetojnë në Itali kohëve të fundit krimi vërehet me goditje të mëdha dhe mjaft të shpeshta, pra ka një rritje të numrit të krimeve dhe se kjo gjë kishte filluar që ta shqetësonte popullatën. Andaj që kjo gjë të dilte e njohur që në fillim dhe që teleshikuesit a lexuesit e lajmit ta kuptonin të vërtetën, titulli në fjalë duhej të ishte shkruar në këtë mënyrë: “Krim i rëndë në Itali, shqiptari e mbyti bashkëshorten në sy të fëmijëve”. Në këtë mënyrë, duke e shtuar fjalën “krim” që në titull të lajmit do të kuptohej shumë më lehtë se qëllimi kryesor është të informuarit e popullit për një krim të bërë në tokën e Italisë, me ç’rast edhe folja e dhënë në kohën e tashme “mbyt duhet të jetë e paraqitur në kohën e kaluar, pra “e mbyti”, duke u mbështetur në përdorimin e drejt të shkrimit/shqiptimit të gjuhës shqipe.

Shembull i fundit për përdorimin e gjuhës shqipe në edicionet e lajmeve të cilat jepen në televizionin privat Alsat M dhe që i takon kësaj pjese të punimit merret edhe titulli i lajmit të publikuar gjithashtu më 9 tetor 2024: “Orban: Pa Serbinë në BE, Ballkani jostabil” (Alsat, Alsat, 2024) Me anë të këtij titulli teleshikuesit e lajmit dhe lexuesit e mëvonshëm duhet ta kuptojnë që sipas Orban-it nëse BE-ja nuk e ka pjesë të veten Serbinë, Ballkani do të jetë i paqëndrueshëm. Që titulli të tingëllonte dhe të dukej më mirë duhej ta kishte këtë formë: “Sipas Orban-it pa Serbinë në BE, Ballkani do të jetë i paqëndrueshëm”. Në këtë mënyrë do të shihej se në vend të fjalës me prejardhje të huaj “jostabil”, në brendi të tekstit të lajmit në fjalë duhej të ishte përdorur fjala shqipe “i paqëndrueshëm”.

Konkluzione

Nga pjesët e mësipërme të punimit u kuptua dhe u përmend fakti se: “Gjuha shqipe sot është identiteti ynë madhështor, e krijuar gjatë shekujsh e mijëvjeçarësh të jetës së rëndë shqiptare dhe është i vetmi thesar që kemi trashëguar nga të parët tanë - ilirët, si monument të plotë më të madh të gjallë deri në ditët tona”(Murati, 2000, f. 58). Duke u njohur në rrjedhë kohe për të veçantat e saj, si dhe duke u shprehur me shenja identifikuese edhe në edicionet e lajmeve (pa i përfshirë rastet tjera), është theksuar me kohë se: “Normat e drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit letrar, pasurimi dhe pastrimi i fjalorit nga lënda e bykut të huaj, përdorimi stilistik i fjalëve dhe i shprehjeve të tjera gjuhësore të figurshme-frazeologjizmave, përbëjnë atë që mund të quhet një shqipe e drejtë, e bukur dhe e qartë” (Murati, 2000, f. 165).

Si e tillë duke ecur nga koha në kohë dhe duke u paraqitur me natyrën e kohës së sotme shihet se përdorimi i kësaj gjuhe në Radio-Televizionin e Maqedonisë, si televizion shtetëror dhe në Alsat M, si televizion privat nuk lidhet aq sa duhet me nevojën e të respektuarit të gjuhës. Duke qenë se edicionet e lajmeve kanë ndikim të madh te njerëzit e një shoqërie, nga kjo që doli më sipër shihet se paraqitja e saj sipas një zhvillimi tashmë të njohur nga të gjithë folësit dhe njohësit e saj mungon në rastet e të dy

televizioneve në fjalë. Në nivel të përgjithshëm, në paralele krahasimtare, shihet se për përdorimin e drejt të gjuhës shqipe dhe për ruajtjen e natyrës së saj, të dy televizionet duhet të kenë kujdes më të madh, të angazhojnë lektorë e redaktorë gjuhe, si dhe të mëtojnë që thelbi i gjuhës, për të cilën dikur u punua fort, të ruhet edhe në të sotmen, pavarësisht territorit apo përdoruesit të saj.

Referenca

- Alsat. (2024, 8 tetor). Ulja e marzhës nuk vërehet në terren – qytetarët: Çmimet e produkteve janë ende të larta. *Alsat – Lajme Vendi*. <https://alsat.mk/ulja-e-marzhes-nuk-vereht-ne-terren-qytetaret-cmimet-e-produkteve-jane-te-larta/>
- Alsat. (2024, 9 tetor). Orbán: Pa Serbinë në BE, Ballkani mbetet i paqëndrueshëm. *Alsat – Bota*. <https://alsat.mk/orban-pa-serbine-ne-be-ballkani-jostabil/>
- Çabej, E. (1970). *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe – Fonetika historike e shqipes*. Prishtinë: Rilindja.
- Cimohovski, V. (1988). *Gjuha shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- CNN Albania. (2024, 9 tetor). Ngjarje e rëndë në Itali – shqiptari mbyth bashkëshorten në sy të fëmijëve. *Alsat – Bota*. <https://alsat.mk/e-rende-ne-itali-shqiptari-mbyt-bashkeshorten-ne-sy-te-femijeve/>
- Deutsche Welle (DW). (2024, 9 tetor). Përshkallëzim i ri në Lindjen e Mesme. *RTM – Lajme Botë*. <https://al.mrt.com.mk/node/133015>
- Frashëri, S. (2002). *Gjuha*. Shkup: Logos-A.
- Murati, Q. (2000). *Gramatika e gabimeve – Kulla babilonike dhe përzierja e shqipes*. Tetovë: ÇABEJ.
- Qamili, R. (2024, 3 tetor). Maqedonia e Veriut përgatitet për zgjedhje. *RTM – Lajme Maqedoni*. <https://al.mrt.com.mk/node/132815>
- Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM). (2024, 30 shtator). Diskutim për rritjen e çmimeve në tregun vendor. *RTM – Lajme Maqedoni*. <https://al.mrt.com.mk/node/132695>
- Rilindja e Lirë. (2024, 9 tetor). Sulmet izraelite vrasin të paktën 12 palestinezë në Gaza. *Alsat – Bota*. <https://alsat.mk/sulmet-izraelite-vrasin-te-pakten-12-palestineze-ne-gaze/>
- Sinani, A. (2016). Zyrtarizimi i gjuhës shqipe në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. *Studime Historike, 03–04*, 235–263. Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Sulejmani, B. (2011). *Gjuha standarde shqipe dhe shkolla – Zotërimi i saj nga nxënësit e shkollave të mesme të Shkupit*. Shkup: Logos-A.
- Sulejmani, B. (2024, 9 tetor). Përleshje mes dy kirurgëve në spitalin e Tetovës – jozyrtarisht janë përdorur edhe mjete të forta. *Alsat – Vendi*. <https://alsat.mk/rrahen-mes-vete-dy-kirurg-ne-spitalin-e-tetoves-jozyrtarisht-jane-perdorur-edhe-mjete-te-forta/>
- Zëri i Amerikës. (2024, 8 tetor). Izraeli vazhdon bombardimet në Gaza. *RTM – Lajme Botë*. <https://al.mrt.com.mk/node/132978>